


# Aksidentet Rrugore

## Nëntor 2020

**Tiranë, më 18 Dhjetor 2020:** Në muajin Nëntor 2020 numërohen 110 aksidente rrugore nga 109 aksidente të ndodhura në muajin Nëntor 2019, duke u rritur me 0,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, numërohen 1.121 aksidente rrugore nga 1.363 aksidente të ndodhura në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, duke u ulur me 17,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Nëntor 2020



**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në muajin Nëntor 2020, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 139 persona nga 144 që ishte një vit më parë, duke u ulur me 3,5 %. Numri i të aksidentuarve në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, është 1.451 persona nga 1.857 persona, duke u ulur me 21,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në muajin Nëntor 2020, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 15 persona nga 21 persona të vdekur në Nëntor 2019. Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 168 persona nga 203 persona në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Nëntor 2020, aksidentet rrugore, në 86,4 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha 25–34

**Për publikim 18/12/2020**

vjeç, duke zënë 25,5 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup-moshë janë ulur me 20,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020, aksidentet rrugore, në 14,1 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur 23,7 %, krahasuar me një vit më parë.

**Tab. 1 Aksidentet rrugore dhe numri i të aksidentuarve sipas gjinisë, Nëntor 2020**

Periudha	Aksidente Gjithsej	Të vdekur		Të plagosur	
		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Nëntor-2019	109	5	16	47	76
Nëntor-2020	110	6	9	36	88
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>0,9</b>	<b>20,0</b>	<b>-43,8</b>	<b>-23,4</b>	<b>15,8</b>
Janar–Nëntor 2019	1.363	54	149	496	1,158
Janar–Nëntor 2020	1.121	37	131	380	903
<b>Ndryshimi vjetor progresiv (%)</b>	<b>-17,8</b>	<b>-31,5</b>	<b>-12,1</b>	<b>-23,4</b>	<b>-22,0</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Tab. 2 Aksidentet rrugore dhe numri i të vdekurve sipas përdoruesve të rrugës, Nëntor 2020**

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Nëntor-2019	83	26	15	6
Nëntor-2020	95	15	15	0
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>14,5</b>	<b>-42,3</b>	<b>0,0</b>	<b>-100,0</b>
Janar–Nëntor 2019	1.156	207	176	27
Janar–Nëntor 2020	963	158	154	14
<b>Ndryshimi vjetor progresiv (%)</b>	<b>-16,7</b>	<b>-23,7</b>	<b>-12,5</b>	<b>-48,1</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Tab. 3 Aksidentet rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit, Nëntor 2020**

Periudha	0 - 24 vjeç	25- 34 vjeç	35- 44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Nëntor-2019	31	35	10	24	4	5
Nëntor-2020	22	28	23	17	10	10
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-29,0</b>	<b>-20,0</b>	<b>130,0</b>	<b>-29,2</b>	<b>150,0</b>	<b>100,0</b>
Janar–Nëntor 2019	282	406	237	265	107	66
Janar–Nëntor 2020	177	336	193	237	109	69
<b>Ndryshimi vjetor progresiv (%)</b>	<b>-37,2</b>	<b>-17,2</b>	<b>-18,6</b>	<b>-10,6</b>	<b>1,9</b>	<b>4,5</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

**Tab. 4 Aksidentet rugore dhe numri i të vdekurve sipas qarqeve, Nëntor 2020**

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Nëntor 2019	Nëntor 2020	Nëntor 2019	Nëntor 2020	Janar-Nëntor 2019	Janar-Nëntor 2020	Janar-Nëntor 2019	Janar-Nëntor 2020
<b>Shqipëria</b>	<b>109</b>	<b>110</b>	<b>21</b>	<b>15</b>	<b>1.363</b>	<b>1.121</b>	<b>203</b>	<b>168</b>
Tiranë	48	44	5	2	583	518	46	31
Durrës	15	10	6	4	115	108	32	28
Shkodër	2	3	1	1	21	24	16	14
Elbasan	7	5	1	1	78	57	21	21
Fier	7	10	2	2	121	83	31	21
Vlorë	3	1	0	0	71	21	7	7
Korçë	7	8	0	1	102	70	15	6
Lezhë	8	11	3	3	146	111	18	20
Berat	2	2	1	0	23	11	3	7
Kukës	2	4	0	1	33	27	5	5
Dibër	2	4	1	0	14	50	6	3
Gjirokastrë	6	8	1	0	56	41	3	5

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve rrugore është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimin në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

## Përkufizime

**Aksidente:** Ngjarje e papritur e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme.

**Aksident me pasoja:** Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet në lëvizje, duke rezultuar në të paktën një person të vrarë ose të dëmtuar. Aksidentet në vendin e punës, depot janë të përjashtuara.

**I vdekur:** I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit,

**I plagosur:** I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit,

**Sjellja e Drejtuesit të Mjetit:** Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj,

**Sjellja e Këmbësorëve:** Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: kalim rruge pa kujdes, etj,

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

*Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).*

## Shpjegimi i simboleve

- 0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse
- pa vlerë
- (...) mungesë të dhënash